



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA PUSTEC

### *PLANI VENDOR I VEPRIMIT PER ZHURMAT NE MJEDIS PER BASHKINE PUSTEC*

- 1- Ne mbeshtetje te rregullores te bashkise Pustec per reduktimin e zhurmave ne mjediset dhe teritoret e bashkise me Urdher te Kryetarit te bashkise u ngrit Grupi I kontrollit te bashkise "Per reduktimin e zhurmave ne mjedisin e bashkise Pustec ":
- 2- Grupi I kontrollit perbehet prej 3 punonjes te bashkise te cilet do te kryejn funksionin e tyre ne mbeshtetje te rregullores dhe te ligjit 9774 dt 12.07.2007 .’Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis si dhe VKM Nr Nr.123, datë 17.2.2011” Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis “.
- 3- Grupi I kontrollit te bashkise do te mundesoje :
  - a- Identifikimin e zonave me efekte më të theksuara të zhurmave dhe popullsia e ekspozuar nga këto pika;
  - b-Identifikimi i pikave ku janë ndërtesa të ndjeshme (qendra shendetesore , shkolla, kopshte ambiente publike , locale etj atje ku frekuentojne njerez .);
  - c –Te jene te pranishem dhe ne bashkepunim me inspektorët e institucioneve kopetente te Qarkut, me Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor. Drejtorine Rajonale për Mjedisit Drejtorine rajonale per shëndetin publik Policin e Rendit e Qarkut ,te cilet e kane per detyre dhe jane ligjerisht kopetente , e tej te kerkojne prej tyre
    - Përcaktimin dhe vlerësimi i masave për reduktimin e zhurmave që shkaktojnë shqetësime ndaj popullsisë;
    - Përcaktimi i kostove të nevojshme për këto ndërhyrje.
    - Kerkese per përfshirjen në sinjalistikën rrugore edhe të sinjaleve që lidhen me zhurmat, si dhe vendosjen e këtyre sinjaleve në pika të caktuara
    - Përfshirja nga specialistet e bashkise ( te cilet pregatitin projekte ) kërkesave specifike për zhurmat në projektet e ndërtimit të rrugëve urbane dhe monitorimi I zbatimit kryesisht afer zonave te cilat kemi folenizim te shpendeve dhe ralla gjate sezonit dhe zonave te banuara .
    - Ndërhyrja në akset rrugore ekzistuese me masa konkrete për reduktimin e nivelit të zhurmave në mjedis në zbatim të planit të reduktimit të tyre: - Rrugët ndërqytetëse; - Rrugët rurale.

- . Pjesa më e rëndësishme dhe njëkohësisht dhe më problematike mbetet zhurmat e gjeneruara nga pajisjet që janë ekspozuar në mjediset publike.  
Në këtë grup pajisjesh përfshihen: - gjeneratorët e tipave dhe madhësi të ndryshme; pajisjet e shpimit të betoneve, asfalte (matrapik, çekiçët pneumatikë, trapan etj.); - pajisje të prerjes së metaleve zmerilues - pajisjet e presimit, vibrimit, rulimit; - eskalatorët, vinçat.

- Vendosja e orarave të lejueshme në ambientet private të bashkise lokale për frenimin e zhurmave akustike (muziken)

- Në bashkëpunim me Punonjësit e Ad ZH Rajoneve të Parkut Kombëtar të Prespes të përcaktohen dhe të vendosen tabela orjentuese të zonave ku kemi folenizim të shpendeve të ralle (duke qene teritor I zones të mbrojtur) duke evituar zhurmat nga pajisjet - pajisje të prerjes së drurëve (motor-sharrat, ) si dhe monitorim i levizjes të motorvarkave në zonat e riprodhimit të peshkut në liqen .

- . Pajisja me leje mjedisi e këtyre aktiviteteve

4-- Grupi I kontrollit të bashkise do të funksionojë për gjithë periudhën vjetore por kyesisht do të shtohet kontrolli gjatë periudhës të sezonit të verës ku nr i vizitoreve është më i madh .

5- Grupi I kontrollit mbas çdo kontrolli do të dalë me raportin e vet i cili do të përcillet edhe në institucione qendrore .

**Hartoi PVV**

**Kesh e Kryetarit  
Ivana SHTYLLA**



**Miratoi**

**Kryetar I bashkise  
Edmond THEMELKO  
Në mungesë dhe me autorizim  
Nën/kryetari Andon JANI**

